

AKT THEMELIMI
I SHOQERISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR
SHOQERIA ALBANA & ARJANI

Lezhë, më 03.09.2025.

THEMELUESI:

1. **Z. Isa Berisha** me atësi Ramadan, amesia Nuriye, shtetas Kosovar i datelindjes 13.05.1954, lindur dhe banues ne Kramovik, Rahovec, Kosove, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit nr. ID0658792 dhe me nr. personal 1250198899.

Themeloj sipas kërkesave te ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" nr. 9901 date 14.04.2008, dhe ligjin nr 9723 date 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare te Biznesit " , si me poshtë:

NENI 1

Te krijoj shoqërinë tregtare me forme ligjore "Shoqeri me Përgjegjësi te Kufizuar" me emrin **ALBANA & ARJANI** e cila do te veproje ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dispozitat e kësaj kontrate, me statutin bashkëngjitur kësaj kontrate, me ligjin "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 date 14.04.2008 dhe formalitetet qe duhen plotësuar ne te.

NENI 2

Selia e Shoqërise do te jete ne adresen: Lezhe, Shenkoll, Tale, zk 1879, pasurine nr. 6/115..

NENI 3

Shoqëria do te ketë për objekt te veprimtarisë te saj ushtrimin e aktivitetit privat ne fushën e : Ndermjetesim ne shitblerje pasuri te luajtshme dhe paluajtshme..

NENI 4

Shoqëria mund te ndryshoje emërtimin, vendqëndrimin, selinë, kohëzgjatjen, pjesëmarrjen e kuotave, objektin e veprimtarisë se saj, me vendim te ortakeve sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë do te jete: **100,000 (qind mije) leke** e përbërë nga 1 (nje) kuota qe i perkasin ortakeve si me poshte.

1. - **Isa Berisha** me 100 % te kapitalit = 1 kuote = 100,000 leke

Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

NENI 6

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve që do të marrin ortakët, por në asnjë rast njeri ortak nuk mund të detyroje ortakët e tjerë të rrisin kuotën e tyre në kapitalin e shoqërisë.

Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të vërtetuara në dokumentet financiare, rezulton me i vogël se gjysma e kapitalit themeltar, ortakët vendosin brenda tre muajve nga miratimi i llogarive të përcaktojnë këtë humbje mbi mundësinë e prishjes së parakohshme të shoqërisë. Në rast se prishja nuk shpallet, shoqëria zvogëlon kapitalin e saj me një vlerë jo më të vogël se ajo e humbjeve që kanë mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

NENI 7

Ortaku që ka ndërmend t'u shesë të tretëve kuota të kapitalit të tij, tërësisht apo pjesërisht, duhet të njoftojë me pare ortakët e tjerë të shoqërisë, të cilët kanë të drejtën e parablerjes qofte dhe në kushte të barabarta. Kjo e drejtë duhet ushtruar brenda 30 ditëve nga data e komunikimit. Për hollësi të mëtejshme ortakët do të referohen dispozitave të parashikuara në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr. 9901 datë 14.04.2008.

NENI 8

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakeve;
- Administratori

Procedura për emërimin në funksionet përkatëse dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit të shoqërisë.

NENI 9

Administrator emerohet **Z. Isa Berisha** me atësi Ramadan, amesia Nuriye, shtetas Kosovari i datelindjes 13.05.1954, lindur dhe banues në Kramovik, Rahovec, Kosovë, madhor dhe me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit nr. ID0658792 dhe me nr. personal 1250198899.

Administratori zgjidhet për një afat 5 (pese) vjeçar me të drejtë ripërtëritjeje.

NENI 10

Vendimet e Asamblesë janë të vlefshme nëse janë miratuar nga ortakët e saj sipas dispozitave të Ligjit Për Shoqëritë Tregtare në lidhje me pjesëmarrjen dhe shumicën e votave sipas kuotave në kapitalin themeltar për Asamblenë e Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme. Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme, kompetencave të ortakeve dhe marrjes së vendimeve do të bazohet në statutin e shoqërisë si dhe në Ligjin "Për shoqëritë tregtare".

NENI 11

Likuiditet dhe transaksionet financiare do të depozitohen në bankat shqiptare dhe në ato të huaja, ku shoqëria ka llogarite e saj rrjedhëse.

Për kapitalin themeltar të shoqërisë është hapur libri i llogarive ku do të shënohet kontributi i ortakut të vetëm. Po kështu shoqëria ka dhe përdor dokumentacionin sipas kërkesave të ligjit për kontabilitetin si dhe gjithë kërkesave të tjera financiare, të domosdoshme për veprimtarinë normale të saj.

NENI 12

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria do të ndahet ndërmjet ortakut të vetëm mbasi të jenë likuiduar të gjitha detyrimet, dhe të jete hequr 5% që do të futet në fondin e rezervës ligjore deri në përmbushjen e 1/10 të kapitalit të shoqërisë.

NENI 13

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj vetëm pasi të ketë marrë autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua në katër dokumente origjinale me fuqi të barabartë secila.

ORTAK I VETEMI I SHOQERISE

1. Isa Berisha

